REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE DURRES

Nr. 135 Rep Nr. 78/1 Kol

NOTERE : BRUNILDA D. ÇEKA

Durres me date 28.01.2019

AKT - MARREVESHJE

PER SHITBLERJE KUOTASH SH.P.K

Sot ne Durres, me date 28 Janar 2019 para meje noterit Brinulda D. Çeka, te dhomes se Noterise Durres, me seli ne Lgj. Nr. 4, Rr. " Egnatja " , u paraqiten personalisht palet kontraktuese si me poshte vijon :

SHITESI:

**SHOQERIA " I - AS " Shpk,** me seli ne Rreshen , Lezhe, Ura e fanit , regjistruar ne QKB (Qendren Kombetare te Biznesitr ) me date 28.05.1999 dhe themeluar me date 21.01.1998, me Numer Unik Identifikimi Subjekti NUIS J98926004Q, perfaqesuar nga ortaku i vetem dhe administratori Z.
**NDUE SHKURTI** , i biri i Gjon-it dhe i Prene -s , lindur ne Simon , Mirdite , me 17. qershor .1961, banues ne Tirane , ne adresen : Nj. Bashkiake Nr. 7 , Rr " Kavajes " , mbajtesi i pasaportes nr. BD5294886 dhe numer personale G10617062H madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, *si pjese e regjimit martesor jep pelqimin bashkeshortja Znj. LIZA SHKURTI ,* e bija e Zef -it dhe e Prene -s, lindur ne Kalivare, Puke , me 01.07.1963, banues ne Tirane , ne adresen : Nj. Bashkiake Nr. 7 , Rr " Kavajes" , mbajtesi e leternjoftimit nr. 028509326 dhe numer personale G35701132T, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar,
(i quajtur me poshte SHITESI)

Pas mbledhjes se Asamblese se Ortakeve te shoqeria " MALIDO - ENERGJI" Shpk , u vendos me vendim nr. 01 prot date 25.01.2019 per dhenien e pelqimit te shitjes se kuotave qe shoqeria I-AS shpk ka ne shoqerin " MALIDO - ENERGJI" Shpk , njerit nga ortakeve te shoqerise, shoqerise " MALIDO " Shpk

DHE

NDUE. SHKURTI          LIZA SHKURTI          Petrit Ileç

BLERESI:

**SHOQERIA " MALIDO " Shpk,** me seli ne Zejmen , Lezhe, regjistruar ne QKB (Qendren Kombetare te Biznesitr ) me date 01.01.2003 dhe themeluar me date 12.02.1995, me Numer Unik Identifikimi Subjekti NUIS K3870048Q , perfaqesuar nga administratori Z. PETRIT PREÇI, i biri i Llesh -it dhe i Dile -s , lindur ne Fregen ,Lezhe , me 01. janar .1975, banues ne Lezhe, ne adresen : Nj. administrative Zejmen mbajtesi i leternjotimit nr. 031919119 dhe numer personale H50101063R madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar
(i quajtur me poshte **BLERESI)** .

Duke marre parasysh se:

A ) SHITESI ( shoqeria I-AS Shpk) eshte ortak dhe pronar 20% te kuotave te kapitalit te shoqerise MALIDO- ENERGJI sh.p.k., e quajtur me poshte SHOQERIA, regjistruar ne QKB (Qendren Kombetare te Biznesit ) me date 24.02.2009 dhe themeluar me date 18.02.2009, me Numer Unik Identifikimi Subjekti NUIS K98824001D , me seli ne Fan , Klos , Hidrocentrali Klos , Lezhe , dhe ka shprehur vullnetin per te shitur te 20 % te kapitalit te kuotatave te SHOQERISE ( prone e shoqerise I-AS shpk ) bleresit ,( shoqerise " MALIDO " Shpk) ortak i shoqerise " Malido - Energji " shpk me 20 % te kapitalit te kuotatave.

B ) BLERESI nepermjet vendimit te ortakut te vetem te shoqerise " MALIDO" Shpk Nr. 09 date 25.01.2019 ka shprehur vullnetin per te blere te gjitha kuotat qe SHITESI ( " I-AS " Shpk ) zoteron ne SHOQERINE ( MALIDO- ENERGJI shpk) qe perbejne 20 % te kuotave te kapitalit te saj.

Palet bien dakort te hartojne dhe te firmosin kete kete AKT MARREVESHJE PER SHITBLERJE KUOTASH :

1. Shitesi shet dhe bleresi blen 20 % te kuotave te kapitalit te SHOQERISE ne pronesi te shitesit sic jane identifikuar ne paragrafin A .

2. Per kete shitblerje palet kane rene dakort dhe percaktojne keto kushte :
Me kalimin e 20 % te kuatove te kapitali qe SHITESI ( "I-AS " shpk ) ka ne pronesi te tij ne SHOQERINE ( Malido - Energji Shpk) ne pronesi te BLERESIT ( " Malido " shpk ) , BLERESI ( " "malido" Shpk) merr persiper keto detyrime :

NDUE SHKURTI LIZA SHKURTI

I - te zhbllokoje te gjitha pasurite e SHITESIT ( " I-AS" Shpk ) qe jane bllokuar dhe konfiskuara per llogari te SHOQERISE (" Malido - Energji" shpk) , vlera totale e zhbllokimi te ketyre pronave eshte ne shumen 30.346.400 LEKE ( tridhjetemilion e treqind e dyzet e gjashtemije e katerqind leke ) , sipas vertetimit bankar dhe tabeles te leshuar nga banka Pro Credit Bank , bashkelidhur kesaj kontrate si pjese perbere e saj

II - BLERESI ( " Malido " shpk ) merr persiper dhe shlyerjen e kredise qe eshte marre nga SHOQERIA ( " Malido Energji " shpk ) prane bankes Pro Credit Bank te pjeses takuese te detyrimit qe ka SHITESI ( " I-AS " Shpk )

III - BLERESI ( " Malido " shpk ) merr persiper qe ne momentin e shlyerjes se kredise te marre nga SHOQERIA (" Malido - Energji" shpk ) te gjitha pronat e vena si koleteral nga BLERESI (" I-AS " shpk ) do te zhbllokohen dhe do te jene te lira nga cdo detyrim ligjor dhe finaciar qe ka lidhje me kredine e marre nga SHOQERIA ( " Malido - Energj" shpk )

**3 - Vlera totale e shitjes se aksioneve nga SHITESI tek BLERESI ne total eshte 70.000 EURO ( shtatedhjetemije Euro )** , nga kjo shume :

**I - 60.000 EURO ( gjashtedhjetemije euro )** i eshte shlyer SHITESIT ( " I-AS " shpk ) nga BLERESI ( ortaku i vetem i shoqerise " Malido " shpk ( " New Technology Hydropower " shpk ) te detyrimeve qe SHITESI ( " I -AS"shpk ) ka pasur ndaj te treteve .

**II-10.000 EURO ( dhjetemije euro )** , BLERESI (" malido " shpk ) merr persiper ti shlyej brenda dates 31.07.2019 , pagese e cila do te behet me banke ne llogarine bankare te Znj. Liza Shkurti , dhe do te vertetohet me mandatin bankar .

**4- BLERESI ( Malido Shpk) merr persiper qe te shlyej te gjitha detyrimet financiare qe SHITESI ( I-AS" Shpk ka ne SHOQERI ( "Malido - Enregji" Shpk ) , ne keto detyrime perfshihet :**

**I - 30.346.400 LEKE ( tridhjetemilion e treqind e dyzet e gjashtemije e katerqind leke )** do te shlyhen nga BLERESI (" Malido " shpk ) sipas marreveshjes qe do te bejne me banken per zhbllokimin e pasurive te bllokuara dhe te konfiskuara permendur ne paragrafin 2 (I) te kesaj kontrate .

5- BLERESI pranon dhe blen kuotat e permendura ne paragrafin 1, pa asnje pretendim apo kundershtim te cdo natyre te tashme/te ardhme ose te lidhur me to.

6- BLERESI ( "Malido" shpk) nga momenti i nenshkrimit te kesaj marreveshje, do te realizoje te gjithe procedurat ligjore per zhbllokimin e pasurive te bllokuara dhe te konfiskuara per llogari te SHOQERISE " Malido - Energji ' shpk

NDUE SHKURTI    LIZA SHKURTI    Petrit Rego

Shkurti

7- **SHITESI dhe BLERESI kane rene dakort qe si data e transferimit te pronesise do te konsiderohet data e regjistrimit te kesaj AKT MARREVESHJE PER SHITBLERJE KUOTASH prane QKB (Qendra Kombetare e Biznesit ).** Ne kete date bleresi do te quhet pronar I vetem ie te gjitha kuotave te shoqerise sikunder shitesi nuk do te kete me ne pronesi asnje kuote te saj.

8- Me transferimin e pronesise te 20 % te kuotave te kapitalit ne **QKB (Qendra Kombetare e Biznesit )** BLERESI ( " Malido " shpk ) do te permbushe dhe te gjitha detyrimet e percaktuar ne kete kontrate , shbllokimin e pasurive , perfshire dhe likujdimin ne vleren 10.000 Euro ne rast te kundert do te demshperblej SHITESIN per cdo dem qe mund ti shkaktoje , nga mos realizimi i detyrimeve te marra persiper ...

9- SHITESI ( I-AS" Shpk ) deklaron se BLERESI ( " MALIDO ' shpk ) nuk asnje detyrim ligjor ose / dhe finaciar , pervec detyrimeve te marra sa me siper , ndaj cdo pretendim i paleve te treta per 20 % te kapitalit qe Zoteron ne SHOQERINE ( "Malido - Energji " shpk) , jane ne garkim te pales SHITESE ( I- SA" Shpk ) .

10 - SHITESI ( I-AS" Shpk ) merr persiper qe cdo shpenzim ekstra per keto prona te bllokuara ose te konfiskuara jane ne ngarkim te tij pervec atyre te marra persiper nga BLERESI ( " Malido " Shpk ) sipas tabeles te leshuar nga banka bashkalidhur kesaj kontrate.

**TE NDRYSHME**

Kjo Kontrate do te rregullohet dhe interpretohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

a) Mosmarreveshjet,pretendimet dhe konfliktet qe lidhen me kete Kontrate,lidhjen, ekzekutimin dhe zgjidhjen e saj,palet zotohen ti zgjidhin me mirekuptim ne rast te kundert,do te zgjidhen perfundimisht nga Gjykata Kompetente.

b) Ne rast se ndonje kusht i kesaj Kontrate apo detyrimet qe rrjedhin prej saj jane te pavlefshme, te paligjshme dhe pa fuqi ne ndonje juridiksion, vlefshmeria, ligjshmeria dhe fuqia e kushteve dhe detyrimeve te tjera, apo kushteve apo detyrimeve te cdo juridiksioni tjeter, nuk do te ndikohen apo dobesohen ne asnje menyre.

c) Palet bien dakort te perpiqen per zevendesimin cdo dispozite te pavlefshem ose te pazbatueshem, me nje dispozite qe permbush ne maksimumin e mundshem qellimet e dispozites te pavlefshme ose te pazbatueshme.

NDUE SHKURTI     LIZA SHKURTI     4

d) Njoftimi dhe cdo lloj tjeter komunikimi ne lidhje me kete Kontrate (Njoftimi) do te jete: (i) me shkrim, (ii) ne Shqip; (iii) dorezuar personalisht ose derguar me poste te parapaguar me konfirmim dorezimi nga Pala marrese.

e) Ne mungese te provave qe njoftimi eshte marre me pare, njoftimi konsiderohet i dhene nese eshte derguar me poste, 5 (pese) dite pune pas postimit.

f) Kjo Kontrate do t'u imponohet dhe do te jete ne favor te Paleve dhe te pasardhesve te tyre dhe personave te lejuar prej tyre.

g) Asnjera nga Palet nuk mund te transferoje asnje prej te drejtave apo detyrimeve te tyre ne kete Kontrate,pjeserisht apo plotesisht,pa aprovimin me shkrim te pales tjeter.

Kontrata iu lexohet paleve te cilet e kuptojne, e pranojne permbatjen e aktit dhe e nenshkruajne ate pa verejtje , duke vene emerin, e mbiemrin , forme e nenshkrimit kjo e percaktuar ne nenin 46 te ligjit nr. 7829 date 01.06.1994 " per Noterine " i ndryshuar "

Kontrata redaktohet ne kater kopje me permbajtje dhe vlere te njete juridike .

Une noterja vertetoj redaktimin korrekt te aktit dhe autenticitetin e nenshkrimeve , ne baze te ligjit 7829 date 01.06.1994 " per Noterine " i ndryshuar " ...

**SHITESI**

Shoqeria I-AS shpk

Ortaku i vetem Z. Ndue Shkurti

NDUE SHKURTI

"I-AS" Sh.p.k. Import - Export RRESHEN - ALBANIA NUIS: J98926004Q Shoqeri Ndertimi

Jep pelqimin bashkeshortja : Znj. Liza Shkurti

LIZA SHKURTI

**BLERESI**

Shoqeria " Malido " shpk

administrator Z. Petrit Preçi

MALIDO SHPK K 38707048Q

Petrit Preçi

**NOTERE**

BRUNILDA D. ÇEKA